

ALBCHROME sh.p.k.

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË

31 DHJETOR 2015

OPINIONI I AUDITUESVE TE PAVARUR	
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E LËVIZJES SË FLUKSEVE MONETARE.....	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	5
2. PËRMbledhja e politikave të rëndësishme kontabël.....	5
3. TË ARDHURAT NGA SHITJET.....	19
4. TË ARDHURA TË TJERA.....	19
5. BLERJE E MATERIALEVE	19
6. SHPENZIME PERSONELI	20
7. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE.....	20
8. ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI.....	21
9. HUMBJET/FITIMET NETO NGA KURSI I KËMBIMIT	21
10. FITIM/HUMBJE NGA INTERESI.....	21
11. TATIMI MBI FITIMIN.....	22
12. TATIM I SHTYRË	22
13. ATKIVE AFATGJATA MATERIALE.....	23
14. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE.....	24
15. AKTIVET MINERARE TË SHTYRA	25
16. INVENTARI.....	26
17. LLOGARI TË ARKËTUESHME	27
18. TË TJERA AKTIVE TË ARKËTUESHME.....	27
19. MJETE MONETARE DHE TË NGJAJSHME	28
20. KAPITALI AKSIONAR	28
21. HUAMARRJET	29
22. LLOGARI TË PAGUESHME	29
23. DETYRIME TË TJERA	29
24. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA	30
25. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT	31
26. VLERA E DREJTË.....	34
27. MENAXHIMI I KAPITALIT	34
28. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA	35
29. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT	35



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUIS: K619110121
Ibrahim Rugova Str, Sky
Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar aksionarit të Albchrome sh.p.k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të Albchrome sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sigurtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa pasaktësi materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sigurtë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015, si dhe të performancës financiare dhe të flukseve monetare të saj për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ernst & Young – Ekspert Kontabël i Autorizuar
Dega në Shqipëri

Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Ernst & Young Certified Auditors
21 korrik 2016
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	2015 LEK'000	2014 LEK'000
Të ardhura nga shitjet	3	6.974.876	4.995.814
Të ardhura të tjera	4	92.583	96.264
Të ardhurat		7.067.459	5.092.078
Ndryshimet e gjëndjes së mallit		193.995	287.579
Blerja e materialeve	5	(3.919.453)	(3.151.207)
Shpenzime për personelin	6	(1.158.524)	(1.018.297)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	7	(577.249)	(425.284)
Zhvlerësim dhe amortizim	8	(727.592)	(364.346)
Humbja neto nga kursi i këmbimit	9	(107.974)	(36.446)
Fitim operativ		770.662	384.076
Të ardhurat nga interesi	10	1.356	817
Shpenzimet nga interesi	10	(34.334)	(26.906)
Fitim para tatimit mbi fitimin		737.684	357.987
Tatimi mbi fitimin	11	(187.142)	(58.252)
Fitim për vitin financiar		550.542	299.735
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		=	=
Totali i fitimit gjithëpërfshirëse për vitin		550.542	299.735

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet sëbashku me shënimet e vendosura në faqet 5 deri 35, që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR Më 31 dhjetor 2015

Shënime	31 dhjetor 2015 LEK'000	31 dhjetor 2014 LEK'000
AKTIVET		
Aktivitet Afatgjata		
Aktivitet afatgjata materiale	13 2.060.839	2.381.388
Aktivitet afatgjata jomateriale	14 210.502	211.111
Aktive minerare të shtyra	15 1,082,438	492.904
Aktiv tatimor i shtyrë	12 -	4.977
	3.353.779	3.100.380
Aktivitet Afatshkurtra		
Mjete monetare e të ngjashme	19 198.521	153.872
Inventari	16 1.767.909	1.426.190
Llogari të arkëtueshme	17 419.477	372.865
Të tjera aktive afatshkurtra	18 589.016	877.942
	2.974.923	2.830.869
TOTALI AKTIVIT	6.328.702	5.931.249
KAPITALI DHE DETYRIMET		
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali aksionar	20 3.765.963	6.847.113
Fitim/ (humbje) të mbartura	427.735	(3.203.956)
	4.193.698	3.643.157
Detyrimet Afatgjata		
Huamarrje afatgjate	21 683.339	369.302
	683.339	369.302
Detyrimet Afatshkurtra		
Huamarrje afatshkurtra	21 303.533	649.543
Llogaritë e pagueshme	22 554.127	603.872
Detyrime ndaj palëve të lidhura	24 23.398	231.998
Detyrime të tjera	23 570.607	433.377
	1.451.665	1.918.790
TOTALI DETYRIMEVE	2.135.004	2.288.092
TOTALI KAPITALIT DHE DETYRIMEVE	6.328.702	5.931.249

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga drejtimi më 1 korrik 2016 nga:

Luan Saliaj
Drejtori Ekzekutiv



Elisabet Hajrullai
Drejtore Financiare

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 35 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali Aksionar LEK'000	Humbje të mbartura LEK'000	Totali LEK'000
1 janar 2014	6.847.113	(3.503.691)	3.343.422
Zvogelim i kapitalit aksionar	-	-	-
Fitim neto i vitit	-	299,735	299,735
31 dhjetor 2014	6.847.113	(3.203.956)	3.643.157
Zvogelim e kapitalit aksionar	(3.081.150)	3.081.150	-
Humbja neto e vitit	-	550.542	550.542
31 dhjetor 2015	3.765.963	427.735	4.193.698

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 35 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

PASQYRA E LËVIZJES SË FLUKSEVE MONETARE
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	31 dhjetor 2015 LEK'000	31 dhjetor 2014 LEK'000
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	737.684	357.987
Korrigjuar për zërat jo-monetare:		
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	8/13 374.361	391.052
Vlerësimi i inventarit	16 -	(126.903)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	353.230	-
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	23.552	-
Të Ardhura nga interesat	(1.356)	(817)
Shpenzime për interesat	34.334	26.906
Aktive të shtyra	4.977	-
	1.526.782	648.225
Korrigjimi për zërat e Kapitalit Qarkullues:		
Rritje në Inventar	16 (341.719)	(304.548)
Rritje në llogari të arkëtueshme	17 (46.612)	(79.218)
Zvogëlim/(Rritje) në llogari të arkëtueshme të tjera	18 288.925	143.066
(Zvogëlim)\Rritje në llogari të tjera të pagueshme	22 (49.745)	(474.429)
Rritje në llogari të tjera të pagueshme ndaj paleve të lidhura	145.414	3.041
	(3.736)	(712.087)
Interesi i paguar	(34.334)	(26.906)
Tatim fitimi i paguar	(187.142)	-
Flukset e parasë neto gjeneruar nga aktivitetet operative	1.301.570	(90.769)
Flukset e parasë nga aktiviteti investues		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	13 (379.611)	(359.427)
Blerja e aktiveve minerare	15 (649.531)	(335.131)
Shitja e aktiveve afatgjata materiale	19.622	-
Flukset e Parasë Neto përdorur për aktivitetet investuese	(1.009.520)	(694.558)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese		
Rritje në huatë afatgjata	480.522	1.472.927
Pages e huave afatgjata	(330.846)	(77.508)
Pagese për overdraftet bankare	(397.077)	(600.215)
Flukset e Parasë të gjeneruara nga aktivitetet financuese	(247.401)	795.203
Rritje neto në mjete monetare dhe të ngjashme	44.649	9.877
Mjete Monetare dhe të ngjashme më 1 janar	153.872	143.996
Mjete monetare dhe të ngjashme më 31 dhjetor	19 198.521	153.872

Pasqyra e lëvizjes së flukseve monetare duhet të lexohet bashkë me grupin e shënimeve në faqet 5 deri 35 që përbëjnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Albanian Chrome sh.p.k. ("Shoqëria") është themeluar më 4 prill 2000, me vendim të gjykatës së rrethit të Tiranës 23.729. Shoqëria fillimisht emërtohej Darfo Albania dhe ishte një degë në pronësi të plotë të DARFO spa, Itali.

- Më 1 qershor 2000 Shoqëria mori në zotërim një koncension të tipit BOT (Ndërto- Opero-Transfero) për objektin e mëposhtëm për 30 vjet, një fabrikë ferro-kromi në Elbasan dhe dy miniera kromi në Përrenjas dhe Pojsk me një vlerë monetare prej LEK 168.000 mijë.
- Më 22 qershor 2001 Shoqëria morri në zotërim një koncension BOT (Ndërto- Opero-Transfero), për objektin e mëposhtëm për 30 vjet, një fabrikë ferro-kromi në Bulqizë, një fabrikë mineralesh të çmuara në Bulqizë, një zonë e veçuar me minerale në Klos dhe fabrikën e ferro-kromit në Burrel me një vlerë monetare prej LEK 248.000 mijë.

Në 2007, Shoqëria ndryshoi emrin e saj nga Darfo Albania shpk në Albanian Chrome shpk. Ndryshimi i emrit erdhi si pasojë e ndryshimit në pronësi nga Darfo në Itali, e cila u ble nga DCM Deco-metal dhe Terwingo. Rrjedhimisht, gjatë 2010 Shoqëria ndryshoi emrin nga Darfo SRL në ACR Holding SRL dhe është një degë në pronësi të plotë të DCM Deco-metal në Austri.

Me 25 shkurt 2013 ACR Holding SRL-Itali u ble plotësisht nga Balfin sh.p.k si rrjedhojë shoqëria kontrolluese ka ndryshuar. Shoqëria gjithashtu ka ndryshuar emrin e saj ne Albchrome sh.p.k.

Zyra e regjistruar e Shoqërisëe ndodhet në Rrugën Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati i 1-rë, nr.3 Tiranë. Shoqëria më 31 dhjetor 2015 ka pasur 1.002 punonjës (31 dhjetor 2014: 978 punonjës).

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

a. Deklarata e perputhshmerise

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

b. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, me përjashtim të investimeve në degët që janë matur me vlerën e drejtë. Monedha e përdorur për paraqitje është Leku Shqiptar (LEK) që është gjithashtu edhe monedha funksionale dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt ('000 Leke), përveç kur përcaktohet ndryshe.

Shoqëria i mban të dhënat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare në pajtueshmeri me Ligjin mbi kontabilitetin nr: 9228, datë 29 Prill 2008 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Shoqëria pasi ka përbushur kushtet përkatëse ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të SNRF (Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar) të cilat u bënë të detyrueshme në Shqipëri me anë të Urdhrit të Ministrisë së Financave Nr. 65 dt.05.05.2008 "Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe".

Parimi i vijueshmërisë

Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare bazuar në parimin e vijueshmërisë.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

c. Ndryshime në Politikat Kontabël dhe Shënimet Shpjeguese

Një numër i ri standardesh të reja, ndryshimesh të standardeve dhe interpretimeve nuk janë bërë ende efektive për periudhën duke filluar nga 1 janar 2015, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk pritet të ketë një efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria nuk ka në plan të adoptojë këtë standard më përpara dhe niveli i ndikimit nuk është përcaktuar.

Standardet dhe interpretimet e publikuara si të detyrueshme për periudhat që fillojnë pas datës 1 janar 2015, për të cilën Shoqëria nuk ka pasur një zbatim të hershëm janë listuar si më poshtë. Ato standarde dhe ndryshime që nuk janë të aplikueshme për Shoqërinë nuk janë paraqitur.

➤ Ndryshime në SNK 19 Skema e përfitimeve të përcaktuara: Kontributet e punonjësve

SNK 19 kërkon që një kompani të marrë në konsideratë kontributet nga punonjësit ose palë të treta kur kontabilizon planin e përfitimeve të përcaktuara. Kur kontributet janë të lidhura me shërbimin, ata duhet ti atribuohen periudhave të shërbimit si një përfitim negativ. Këto ndryshime qartësojnë që nëse vlera e kontributeve nuk ka të bëjë dhe është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit, një shoqëri është e lejuar të njohë këto kontribute si një pakësim në koston e shërbimit në periudhat kur shërbimi është dhënë, në vënd që të shpërndahen kontributet sipas periudhave të shërbimit. Ky amendament është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014. Kjo është në përputhje me politikën kontabilitetit e tanishme të kompanisë dhe, në këtë mënyrë, ky ndryshim nuk ndikon në politikën kontabël të kompanisë.

➤ SNK 16 Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje dhe SNK 38 Aktivet Jo-materiale

Amendamenti është aplikuar në mënyrë retrospektive dhe sqarohet në SNK 16 dhe SNK 38 që aktivi mund të jetë rivlerësuar duke iu referuar të dhënave të vëzhguara nga duke rregulluar shumën bruto kontabël të aktivitetit sipas vlerës së tregut ose me përcaktimin e vlerës së tregut të vlerës kontabël dhe rregullimin e vlerës kontabël bruto në mënyrë proporcionale, në mënyrë që rezultojnë që vlera kontabël të jetë e barabartë me vlerën e tregut. Përveç kësaj, amortizimi i akumuluar apo amortizimi është diferenca e shumave bruto me ato neto të aktivitetit. Ky ndryshim nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të kompanisë gjatë periudhës aktuale pasi nuk ka rivlerësime të kryera.

➤ SNK 24 Informacioni shpjegues mbi palët e lidhura

Amendamenti është aplikuar në mënyrë retrospektive dhe sqaron se një njësi e menaxhimit (një njësi ekonomike që ofron shërbime të rëndësishme të menaxhimit të personelit) është një palë e lidhur në dhënie të informacioneve shpjeguese për palët e lidhura. Përveç kësaj, një njësi ekonomike që përdor një kompani menaxhimi është e nevojshme që të paraqesë shpenzimet e bëra për shërbimet e menaxhimit. Ky ndryshim është relevante për Kompaninë sepse ajo ka marrë shërbime të menaxhimit nga subjektet e tjera.

➤ SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë

Amendamenti zbatohet në mënyrë prospektive dhe sqaron se përjashtime portofoli sipas SNRF 13 mund të aplikohet jo vetëm për aktivet financiare dhe pasivet financiare, por edhe për kontratat e tjera brenda objektit të SNK 39.

d. Standardet ende jo efektive

Standardet dhe interpretimet e lëshuara, por ende nuk është efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të kompanisë janë paraqitur më poshtë. Shoqëria synon të zbatojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, që në momentin kur ato hyjnë në fuqi.

➤ SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja

Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018, por lejohet adoptimi i hershëm. Faza përfundimtare e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjithë versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. Drejtimi është duke vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi dhe nëse ky standard do të aplikohet më herët.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d. Standardet ende jo efektive

➤ **SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët**

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017. SNRF 15 përcakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve jo-financiare që nuk janë transaksione të veprimtarisë të zakonshme të njësisë ekonomike (p.sh. shitja e aktiveve afatgjata material dhe jo-materiale). Dhënia e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshi ndarjen e të ardhurave totale, informacionin rreth detyrimeve të performancës, ndryshimet në llogaritjen e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, gjykimeve dhe vlerësimit. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin që standardi do të ketë, megjithatë nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm.

➤ **SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshuar)**

Ndryshimi behet efektiv nga data 1 janar 2016. Ky ndryshim do të lejojë entitetet të përdorin metodën e kapitalit për të llogaritur investimet në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe investime në pjesëmarrje në pasqyrat e tyre financiare individuale, si dhe do të ndihmojë disa juridiksione të lëvizin drejt SNRF, për pasqyrat financiare individuale, duke ulur kostot e përputhshmërisë pa zvogëluar informacionin e disponueshëm për investitorët. Shoqëria nuk ka investime në njësi ekonomike të tjera dhe amendimi nuk do të ketë ndikim.

➤ **Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38: Sqarimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit**

Ndryshimet qartësojnë parimin në SNK 16 dhe SNK 38 që e ardhura pasqyron një model të përfitimeve ekonomike që është krijuar nga operimi i biznesit (në të cilin aktiviteti është pjesë) sesa përfitimet ekonomike nga konsumi nëpërmjet përdorimit të aktivitetit. Si rezultat, një metodë bazuar në të ardhurat nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar ndërtesat, paisjet dhe mund të përdoret vetëm në rrethana shumë të kufizuara për amortizimin e aktiveve jo-materiale.

Ndryshimet janë efektive në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, adoptimi më i hershëm është i lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë ndikim të shoqërisë duke pasur parasysh se Shoqëria nuk ka përdorur një metodë të ardhurave bazuar në të zhvlerësohet asetet e saj afatgjata.

➤ **SNK 19 Përfitimet e Punonjësve**

Ndryshimi sqaron se thellësia e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, se sa vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, duhet të përdoren normat e obligacioneve qeveritare.

➤ **SNK 1: Paraqitja e shënimeve shpjeguese (Ndryshuar)**

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare sqarojnë sesa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:

- materialitetin sipas kërkesave të SNK 1
- rreshtat specifik në të cilat mund të ndahet pasqyra e fitimit, humbjeve dhe të ardhurave të tjera dhe pasqyrën e pozicionit financiar,
- se subjektet kanë fleksibilitet për sa i përket rendit në të cilën ata paraqesin shënime për pasqyrat financiare
- se pjesa e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit neto duhet të paraqiten si një zë në total, dhe të klasifikuar mes atyre artikujve që do apo nuk do të jenë më pas të rriklassifikuar në fitim ose humbje

Për më tepër, ndryshimet qartësojnë kërkesat që zbatohen kur nëntotale shtesë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe deklaratën / deklaratat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera. Këto ndryshime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016, me miratimin e hershëm të lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në Shoqëri.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABEL (VAZHDIM)

e. Konvertimi në monedhë të huaj

Transaksionet dhe gjendjet

Transaksionet në monedhë të huaj fillimisht regjistrohen nga Shoqëria me kursin e këmbimit respektiv në datën që kryhet transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në valutë të huaj rivlerësohen me kursin e këmbimit të monedhës funksionale në datën e raportimit. Të gjitha ndryshimet vendosen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim të të gjitha njësive monetare që ofrojnë mbrojtje për një investim neto në një operacion të huaj. Këto njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në momentin e ç' regjistrimit të investimit neto, kohë në të cilin ato njihen në pasqyrën e të ardhurave. Shpenzimet dhe kompensimet fiskale të cilat i detyrohen ndryshimeve të kursit të këmbimit të njësive monetare gjithashtu regjistrohen tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Njësitë jo-monetare të cilat maten me kosto historike në valutë të huaj përkthehen duke përdorur kurset e këmbimit në datat e fillimit të transaksioneve. Njësitë jo-monetare të cilat maten me vlerën e drejtë në valutë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është përcaktuar. Humbja ose fitimi i krijuar nga ripërkthimi i njësive jo-monetare trajtohet në të njëjtën mënyrë me njohjen e fitimeve ose humbjeve që rezultojnë nga ndryshimi në vlerën e drejtë të njësisë. (që do të thotë: diferencat e konvertimit të njësive, fitimet ose humbjet nga vlera e drejtë e të cilave njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose në fitim-humbjet njihen gjithashtu në të ardhura të tjera të tjera gjithëpërfshirëse ose fitim-humbje, respektivisht).

f. Njohja e te ardhurave

Të ardhurat njihen në atë masë në të cilën është e mundur që përfitimet ekonomike të rrjedhin drejt shoqërisë dhe të ardhurat të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur do të kryhet pagesa. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh kushtet e përcaktuara në kontratën e pagesës dhe duke përjashtuar taksat apo detyrimet. Shoqëria vlerëson marrëveshjet e saj të të ardhurave përkundrejt kritereve specifike në mënyrë që të përcaktojë nëse ajo është duke vepruar si palë e drejtpërdrejtë apo agjente. Shoqëria ka arritur në përfundimin se është duke vepruar si palë e drejtpërdrejtë në të gjitha marrëveshjet e të ardhurave.

Gjithashtu kriteret e mëposhtme specifike të njohjes duhet të plotësohen para se të ardhurat të njihen:

Shitja e mallrave

E ardhura nga shitja e mallrave njihet kur risqet dhe përfitimet e pronësisë së mallrave kanë kaluar te blerësi, zakonisht bashkë me dorëzimin e mallrave.

Dividentët

Të ardhurat njihen kur është përcaktuar e drejta e shoqërisë për të marrë pagesën.

Të ardhura nga interesi

Të ardhurat lidhen me depozitat me afat dhe njihen kur maturohet interesi. Të ardhurat nga interesi përfshihen në të ardhurat financiare në pasqyrën e të ardhurave.

g. Taksa

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi të ardhurat për periudhën aktuale matet me shumën që pritet të rimerret nga ose paguhet autoriteteve tatimore. Normat dhe legjislacioni tatimor i përdoruar për të llogaritur shumën e tatimit mbi fitimin janë ato që janë në fuqi ose që konsiderohen të tilla, në datën e raportimit në vendet ku Shoqëria operon dhe gjeneron të ardhura të tatueshme.

Tatimi aktual mbi të ardhurat lidhur me njësitë që njihen drejtpërdrejtë në kapitalin neto, njihet në kapital dhe jo në pasqyrën e të ardhurave. Menaxhimi periodikisht vlerëson pozicionet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e aplikueshme tatimore janë subjekt interpretimi dhe krijon provigjone aty ku është e përshtatshme.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g. Taksa (vazhdim)

Tatim i shtyrë

Tatimi i shtyrë llogaritet duke përdorur metodën e detyrimit bazuar në diferencat e përkohshme në datën e raportimit midis bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës së mbetur për qëllime të raportimit financiar. Vlera kontabël e aktivitetit tatimor të shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është më e mundshme që fitimi i mjaftueshëm i tatuueshëm të jetë në dispozicion për të lejuar tatimin e shtyrë të aktiveve të përdoret. Aktivitetet e panjohura tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë masë që është bërë e mundur që fitimi i tatuueshëm i ardhshëm do të lejojë tatimin e shtyrë të aktiveve të rimerret.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra maten me normat tatimore që priten të zbatohen në vitin kur aktivi do të përfitohet ose detyrimi shlyhet, bazuar në normat e tatimeve (dhe ligjet tatimore) të cilat janë në fuqi ose kanë hyrë në mënyrë thelbësore në fuqi në datën e raportimit (p.sh. 15%). Tatimi i shtyrë në lidhje me njësitë e njohura jashtë fitimit ose humbjes njihet jashtë pasqyrave të fitimit ose humbjes. Zërat tatimore të shtyrë njihen në korrelacion me transaksionin me të cilin lidhen ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen, nëqoftëse një e drejtë ligjërishme e detyrueshme ekziston për të vendosur kompesimin e aktiveve tatimore aktuale ndaj tatimit mbi të ardhurat e pasiveve dhe tatimeve të shtyra që lidhen me të njëjtin entitet të tatuueshëm dhe të njëjtin autoritet tatimor.

Taksat mbi shitjet

Të ardhurat, shpenzimet dhe aktivitetet regjistrohen me vlerën neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, përveç:

- Kur taksa mbi shitjet vendoset në blerjen e aktiveve ose shërbimeve nuk është e kreditueshme nga autoritetet tatimore në këtë rast, taksa mbi shitjet është e njohur si pjesë e kostos së blerjes së aktiveve ose si pjesë e mjeteve shpenzuese.
- Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme që janë të ndërlidhura me shumën e shitjeve janë të tatuueshme.

Vlera neto e TVSH e konvertuar nga, ose e paguar për, autoritetet tatimore përfshihet si pjesë e llogarive të pagueshme dhe të arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar.

h. Aktivitetet afatgjata materiale

Aktivitetet Afatgjata Materiale janë deklaruar me vlerën kontabël neto, pas zbritjes së amortizimit të akumuluar dhe/ose humbjeve të akumuluar nga zhvlerësimi. Kjo kosto përfshin kostot e zëvendësimit të një pjese të tokës, ndërtesës, makinerive dhe pajisjeve dhe kostove të huamarrjes për një periudhë afat-gjatë të projekteve të ndërtimit nëqoftëse kriteret e njohjes përmbushen. Kur një pjesë e rëndësishme e tokës, ndërtesës, makinerive dhe pajisjeve kërkohet që të zëvendësohet me intervale, Shoqëria i njëh këto pjesë si aktive individuale me një jetë të dobishme dhe amortizim specifik respektiv. Po kështu, kur një rikonstrukcion me vlerë të konsiderueshme është kryer, kostot e tij njihen në vlerën e mbetur të tokës dhe pajisjeve si një zëvendësim nëse kriteret e njohjes janë përmbushur. Të gjitha kostot e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes do të njihen në pasqyrat e të ardhurave atëherë kur ndodhin. Vlera aktuale e kostos së pritshme për çmontimin e aktivitetit pas përdorimit të tij është përfshirë në koston e aktivitetit përkatës, nëse kriteret e njohjes për një provigjon janë përmbushur.

Amortizimi llogaritet mbi një bazë lineare mbi jetëgjatësinë e aktiveve si vijon:

➤ Ndërtesa	12.5 deri në 35 vjet
➤ Makineri dhe pajisje	8 deri në 15 vjet
➤ Automjete	5 vjet
➤ Pajisje kompjuterike	4 vjet
➤ Mobilje	8 vjet

Vlera kontabël e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe çdo pjesë e rëndësishme e njohur në fillim, nuk njihet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime të ardhshme nga përdorimi ose nga shitja e tij.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABELË (VAZHDIM)

h. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

Çdo fitim ose humbje që vjen nga mosnjohja (ç'regjistrimi) e aktivitetit (llogaritur si diferencë mes të ardhurave nga pakësimi dhe vlerës kontabel të aktivitetit), përfshihet në pasqyrën e të ardhurave kur aktiviteti ç'regjistrohet.

Vlera e mbetur e aktivitetit, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen çdo periudhë financiare, duke bërë ndryshimet e nevojshme sipas rastit.

Çvlerësimi

Në datën e raportimit Shoqëria vlerëson nëse ka një tregues që një aktiv mund të jetë çvlerësuar. Nëse ndonjë tregues ekziston, ose kur testimi vjetor për çvlerësim për një aktiv është i nevojshëm, Shoqëria vlerëson vlerën e rikuperueshme të aktivitetit. Shuma e rikuperueshme përcaktohet për një aktiv individual, përveç nëse aktiviteti nuk krijon flukse monetare hyrëse të cilat janë kryesisht të pavarura nga aktivitetet ose grupet e aktiveve të tjera.

Mirëmbajtja dhe riparimet

Shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparimet kryesore përfshijnë koston e zëvendësimit të aktiveve ose pjesëve të aktiveve dhe koston e riparimeve. Kur një aktiv ose pjesë e një aktiviteti që është amortizuar pjesërisht dhe që është fshirë përfundimisht dhe zëvendësuar me një tjetër, dhe është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike të ndërlidhura me objektin do t'i vijin Shoqërisë përgjatë jetës së saj të zgjatur, në këtë mënyrë shpenzimi kapitalizohet.

Kur pjesë e një aktiviteti nuk konsiderohet në mënyrë të ndarë si një komponent, vlera e zëvendësimit përdoret për të parashikuar totalin e vlerës së aktivitetit që zëvendësohet i cili fshihet menjëherë nga pasqyrat financiare. Të gjitha shpenzimet e tjera për mirëmbajtjen që ndodhin në përditshmëri shënohen si shpenzime në momentin që ndodhin.

i. Kostot e shtyra të nxjerrjes së mineralit – Aktive Afatgjata të Shtyra

Kostot e shtyra të nxjerrjes së mineralit që ndodhin gjatë zhvillimit të një minierë përpara fillimit të prodhimit, kapitalizohet si pjesë e koston së ndërtimit të minierës dhe rrjedhimisht amortizohet mbi bazë lineare përgjatë jetës së minierës.

Kostot e gërmimit që akumulohen përgjatë fazës së prodhimit, shtyhen përgjatë ushtrimit të aktiviteteve operative sepse kjo është baza më e përshtatshme për të ndërlidhur kostot kundrejtë përfitimit ekonomik që këto sjellin dhe ky efekt është material. Kryesisht ky është rasti kur ka devijacion në kostot e gërmimit në jetëgjatësinë e minierës. Vlera e kostove të gërmimit ndryshon në bazë të koston aktuale që vjen si pasojë e gërmimit deri sa arrihet zbulimi i mineraleve. Ky ndryshim i kostove i atribuohet më pas fitimit ose humbjes bazuar në sasinë e mineraleve të nxjerra nga niveli i arrirë respektivisht. Ndryshimet njihen në datën kur këto ndryshime bëhen të njohura. Kostot e ndryshuara të gërmimit janë përfshirë si pjesë e 'Aktiveve minerare të shtyra'. Kjo bën pjesë në totalin e investimit për gjenerimin e mjeteve financiare, të cilat rishikohen për pasaktësi nëse evente të caktuara ose ndryshime në rrethana tregojnë që vlera totale që ajo mbart nuk mund të arrihet të rimerret e gjitha.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

j. Qeratë

Përcaktimi nëse një marrëveshje është ose përmban terma qeraje, bazohet në përmbajtjen e marrëveshjes në datën e fillimit të saj, nëse përmbushja e marrëveshjes ka të bëjë me përdorimin e aktivit, ose aktiveve specifike ose marrëveshja përcakton të drejtën e përdorimit të aktivit, edhe pse e drejta nuk është shprehur qartë në një marrëveshje.

Shoqëria si një qeramarrëse

Qeratë financiare të cilat transferojnë tek Shoqëria në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që shoqërojnë pronësinë e aktivit të marrë me qera, kapitalizohen në momentin e fillimit të qerasë me vlerën e drejtë, ose në të kundërt, nëse vlera e drejtë është më e vogël, me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë. Pagesat e qerasë shpërndahen mes detyrimeve financiare dhe zvogëllimit të detyrimit të qerasë, në mënyrë që të sigurohet një normë interesi e qëndrueshme në balancën e mbetur të detyrimit. Detyrimet financiare njihen si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave.

Një aktiv i marrë me qera amortizohet përgjatë jetës së dobishme të tij. Megjithatë, nëse në fund të periudhës së qerasë, nuk ekziston një mundësi e arsyeshme që Shoqëria të fitojë pronësinë mbi aktivin, aktivi amortizohet përgjatë periudhës më të shkurtër midis jetës së dobishme të vlerësuar dhe kohëzgjatjes së qerasë.

Pagesat e qerasë operative njihen si një shpenzim operativ në pasqyrën e të ardhurave, bazuar në metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

k. Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi, që kërkojnë një kohë të rëndësishme për të përgatitur aktivin për përdorim apo për shitje, kapitalizohen si pjesë e kostove të aktivit përkatës. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes, përfshihen në shpenzimet e periudhës në të cilën ndodhin. Kostot e huamarrjes përbëhen nga interesa dhe kosto të tjera në lidhje me huamarrjen e fondeve.

Shoqëria kapitalizon kostot e huamarrjes për të gjitha aktivet e kualifikuara, për të cilat ndërtimi ka filluar më 1 janar 2009.

l. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Aktivt afatgjata jomateriale të përftuara veçmas maten me koston fillestare të njohjes. Kostoja e një aktivi afatgjatë jomaterial të blerë në një kombinim biznesi, është vlera e drejtë në datën e blerjes. Duke ndjekur njohjen fillestare, aktivt afatgjata jomateriale mbahen me koston minus amortizimin e akumuluar, dhe zhvlerësimin e akumuluar, nëse ka.

Aktivt afatgjata jomateriale të gjeneruara nga biznesi, duke përjashtuar kostot e zhvillimit, nuk kapitalizohen dhe shpenzimet përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit në të cilin kanë ndodhur.

Aktivt afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar amortizohen përgjatë jetës së tyre të dobishme ekonomike dhe i nënshtrohen testimit për zhvlerësim sa herë që ekziston një faktor që aktivi afatgjatë jomaterial duhet të zhvlerësohet. Periudha dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar, rishikohet të paktën çdo fund periudhe raportimi. Ndryshimet në jetën e dobishme të pritshme ose në modelin e pritshëm të konsumimit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të përfshira në aktiv llogaritën duke ndryshuar metodën ose periudhën e amortizimit, siç është e përshtatshme, dhe trajtohen si ndryshim në vlerësimet kontabël. Shpenzimet e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar njihen në pasqyrën e të ardhurave në kategorinë e shpenzimeve bazuar në funksionin e aktivit afatgjatë jomaterial.

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar është si më poshtë:

Tarifat e Koncesionit 30 vjet

Fitimi apo humbja nga mosnjohja (çregjistrimi) i një aktivi afatgjatë jomaterial, matet si diferencë mes të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël të aktivit. Këto të ardhura njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi çregjistrohet.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

m. Detyrimet Financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare në kuadrin e SNK 39 klasifikohen si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes, kredive dhe huamarrjes, ose si instrumenta derivative mbrojtës. Shoqëria përcakton klasifikimin e detyrimeve financiare në momentin e njohjes fillestare.

Të gjitha detyrimet financiare në momentin fillestar njihen me vlerën e drejtë, dhe në rastin e kredive dhe huamarrjeve i shtohen dhe kostot e transaksionit që ngarkohen drejtpërdrejtë.

Detyrimet financiare të shoqërisë përfshijnë llogaritë e pagueshme, overdraftet bankare, kreditë dhe huamarrjet.

Matja e mëpasshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi, si më poshtë:

Huamarrjet

Pas njohjes fillestare, interesat e huave dhe huamarrjeve maten në vazhdimësi me koston e amortizuar, duke përdorur normën efektive të interesit. Fitimi dhe humbja njihen në pasqyrën e të ardhurave kur detyrimet janë njohur gjithashtu me metodën e amortizimit duke përdorur normën efektive të interesit.

Kostoja e amortizimit llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje apo prim si dhe komisione apo kosto të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit (EIR). Norma efektive e interesit është e përfshirë në kostot financiare të pasqyrës së të ardhurave.

Kontratat e Garancive Bankare

Kontratat e garancive bankare të lëshuara nga Shoqëria janë ato kontrata të cilat kërkojnë kryerjen e një pagese për të rimbursuar mbajtësin e saj për një humbje e cila ndodh për shkak se debitori i specifikuar nuk arrin të kryejë një pagesë në kohën e duhur sipas termave të pagesës. Kontratat e Garancive Financiare njihen fillimisht si detyrim me vlerën e drejtë, rregulluar me kostot e transaksionit, të cilat lidhen drejtpërdrejt me lëshimin e garancisë. Në vazhdim, detyrimi matet me vlerën më të madhe mes vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të kërkuara në datën e raportimit dhe shumës së njohur minus amortizimin e akumuluar. Rrjedhimisht, detyrimi matet me vlerën më të lartë mes vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të kërkuara për të shlyer detyrimin aktual në datën e raportimit dhe shumës së njohur minus amortizimit të akumuluar.

Mosnjohja

Një detyrim financiar ç'regjistrohet nga pasqyra e pozicionit financiar kur detyrimi është përmbushur, anuluar ose i ka kaluar afati.

Kur një detyrim financiar zëvendësohet nga një detyrim tjetër nga po i njëjti huadhënës me terma të ndryshuara, ose termat e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë të konsiderueshme, ky ndryshim apo modifikim, trajtohet si një mosnjohje e detyrimit fillestar dhe njohje e detyrimit të ri, dhe diferenca në vlerën respektive kontabël njihet në pasqyrën e të ardhurave.

Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivët financiarë dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe vlera neto raportohet në pasqyrat e konsoliduara financiare, në qoftë se dhe vetëm në qoftë se ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura të tyre dhe ekziston qëllimi për t'i shlyer në vlerën neto, ose për të njohur aktivin dhe shlyer detyrimin në të njëjtën kohë.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

n. Inventarët

Inventarët vlerësohen me koston më të vogël mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot e nevojshme për sjelljen e produkteve në vendndodhjen dhe kushtet e tyre aktuale kontabilizohen si më poshtë:

-Lëndët e para

Me koston e blerjes me metodën FIFO

-Produktet e gatshme dhe prodhimi në proces:

Me koston e punës dhe materialeve direkte dhe një pjesë të shpenzimeve të tjera të përgjithshme bazuar në kapacitetin normal prodhues, por duke përjashtuar kostot e huamarrjes. Kosto fillestare e inventarit përfshin transferimin e fitimit apo të humbjes, rezultuar nga ndërmarrja e pozicioneve mbrojtëse të fluksit monetar, të njohura në fitim-humbje, në lidhje me blerjet e lëndëve të para.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të përfundimit të procesit të prodhimit dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për të kryer shitjen.

o. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëqoftëse ka tregues se aktivet mund të jenë zhvlerësuar. Në rast se ekziston një tregues i tillë, ose kur testimi vjetor për një aktiv të zhvlerësuar kërkohet, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e aktivit është vlera më e lartë mes vlerës së drejtë të njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare minus koston së shitjes dhe vlerës në përdorim të aktivit, dhe përcaktohet për një aktiv individual, përveçse kur aktivin nuk gjeneron flukse monetare hyrëse të cilat janë më se shumti të pavaruara nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të aktiveve të shoqërisë. Kur vlera kontabël e një aktivit ose e njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën e vlerës së rikuperueshme, aktivin konsiderohet i zhvlerësuar dhe vlera e tij zvogëlohet deri në vlerën e tij të rikuperueshme.

Gjatë përcaktimit të shumës në përdorim, flukset e pritshme monetare skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur normën e zbritjes para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për këtë aktiv. Në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostove të transaksionit, merren në konsideratë transaksionet më të fundit në treg, në rast se ka të tilla. Në rast se transaksione të tilla nuk identifikohen, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi. Këto llogaritje mbështeten nga vlerësime të shumëfishta, çmimet e aksioneve të kuotuar për filialet e tregtuara në bursa, ose tregues të tjerë të vlerës së drejtë.

Shoqëria e bazon llogaritjen e zhvlerësimit në buxhete të detajuara dhe parashikime të cilat janë përgatitur veçmas për çdo njësi të gjenerimit të mjeteve monetare të shoqërisë, të cilat janë të alokuara aktivet individuale. Buxhetet dhe parashikimet përgjithësisht mbulojnë një periudhë pesë vjeçare. Për periudha më të gjata llogaritet një normë afatgjatë rritjeje dhe aplikohet në skontimin e flukseve monetare të ardhshme pas vitit të pestë.

Humbjet nga zhvlerësimi për operacionet e vazhdueshme, duke përfshirë zhvlerësimet në inventar, njihen në pasqyrën e të ardhurave në ato kategori shpenzimesh në përputhje me funksionin e aktivit të zhvlerësuar, përveç pronave të rivlerësuara paraprakisht kur rivlerësimi është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Në këtë rast zhvlerësimi njihet gjithashtu në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në shumën e ndonjë rivlerësimi të mëparshëm.

Për aktivet me përjashtim të emrit të mirë, bëhet një vlerësim në çdo datë raportimi në rast se ka ndonjë tregues që tregon që humbjet nga zhvlerësimet nuk ekzistojnë ose janë ulur. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit ose të njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare. Humbjet e mëparshme të zhvlerësimit mund të kthehen vetëm nëqoftëse ka pasur një ndryshim në supozimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivit që nga njohja e fundit e humbjes nga zhvlerësimi. Ky kthim është i kufizuar në mënyrë që shuma e mbartur e aktivit as të mos kalojë shumën e rikuperueshme dhe as të mos tejkalojë shumën e mbartur e cila do të ishte e përcaktuar, si amortizim neto, në rast se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk do të ishte njohur për aktivin në vitet e mëparshme. Ky kthim njihet në pasqyrën e të ardhurave përveçse kur aktivin mbahet me vlerën e rivlerësuar të aktivit, rast në të cilin rikthimi trajtohet si një rritje nga rivlerësimi.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

o. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)

Aktivët e mëposhtme kanë karakteristika specifike për testimet e zhvlerësimit:

Aktivët jomateriale

Aktivët jomateriale me jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar testohen për zhvlerësim individual ose në nivel njësie të gjenerimit të parasë, sipas rastit, çdo vit me 31 dhjetor, dhe kur rrethanat tregojnë që vlera e mbartur mund të jetë zhvlerësuar.

p. Aktive financiare

Aktivët financiarë që janë brenda fushës së SNK 39 klasifikohen ose si aktive financiare me vlerën e drejtë nepermjet fitimit ose humbjes, si hua dhe llogari të arkëtueshme, investimet të mbajtura në maturim ose aktive financiare të vlefshme për shitje. Kur aktivët financiarë njihen fillimisht, ato maten me vlerën e drejtë, plus, në rastet e investimeve jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, i shtohen edhe kostot e transaksionit. Shoqëria përcakton klasifikimin e aktiveve financiare gjatë njohjes fillestare dhe kur është e përshtatshme dhe e lejuar, rivlerëson këtë klasifikim në çdo fund viti financiar.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e rregullta të mjeteve financiare njihen në datën e tregtimit, psh data kur Shoqëria angazhohet të kryejë blerjen e aktivit. Blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt janë blerje ose shitje të aktiveve financiare të cilat kërkojnë dorëzimin e aktiveve brenda periudhës së përcaktuar nga rregulloret ose marrëveshjet në tregun e shitjes.

Për vitet financiare nën rishikim, Shoqëria nuk ka pasur në zotërim asnjë nga aktivët financiarë të lartë-përmendura përveç llogarive të arkëtueshme e të tjera përfshirë të arkëtueshmet nga palët e lidhura.

Llogaritë e arkëtueshme nga klientët dhe të tjerat përfshirë kërkesat nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga klientët dhe kërkesa të tjera, përfshirë kërkesat nga palët e lidhura njihen dhe mbarten me shumën e faturës origjinale duke i zbritur provigjonet për shumat e paarkëtuara.

Zhvlerësimet e aktiveve financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë të bilancit në rast se ka ndonjë evidence objektive që një aktiv financiar ose grup aktivësh financiarë të janë zhvlerësuar.

Në lidhje me llogaritë e arkëtueshme nga klientët dhe palët e lidhura, krijohet provigjon për zhvlerësimin e tyre kur ka evidence objektive (në rast pa aftësie paguese ose vështirësive financiare të debitorit) se Shoqëria nuk do jetë e aftë të mbledhë shumat përkatëse sipas kushteve origjinale të faturës. Vlera kontabël e të arkëtueshmeve ulet përmes llogarisë së zbritjes (provigjonit). Borxhet e zhvlerësuarat ç'registohen (fshihen) kur ato vlerësohen si të pambledhshme (të pararkëtueshme).

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to

Paratë dhe depozitat afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar përbëhen nga vlera monetare në banka, në arkë dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose më pak. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të përcaktuara më lart, pasi i zbritet teprica e overdratëve bankare.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

p. Përfitimet e punonjësve

(i) Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostoja që ndodh për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen respektive brenda vitit ushtrimor.

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqëria njih si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhur me lejen vjetore e cila pritët të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën e kryer.

q. Provizionet

Të përgjithshme

Provizionet janë njohur kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarje të kaluar, është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Kur Shoqëria pret që disa ose të gjitha provizionet të rimbursohen, p.sh nën një kontratë sigurimi, rimbursimi njihet si një aktiv i vecantë, por vetëm kur rimbursimi është i sigurt. Shpenzimet e lidhura me provizionet paraqiten në Pasqyrën e të Ardhurave neto nga cfarëdo rimbursim (duke i zbritur shumat e rimbursuara).

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë detyrime për të paguar mallrat ose shërbimet që janë fituar në rrjedhën e zakonshme të biznesit nga furnitorët. Llogaritë e pagueshme klasifikohen si detyrime aktuale nëse pagesa kryhet brenda një viti ose më pak (ose në ciklin normal operativ të biznesit, nëse është më i gjatë). Në rast se jo, ato janë paraqitur si detyrime afatgjata.

r. Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorigjueshme.

s. Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësime dhe supozime

Përgatitja e Pasqyrave Financiare të shoqërisë kërkon që manaxhimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve dhe dhënies së shpjegimeve për detyrimet e kushtëzuara, në fund të periudhës raportuese. Megjithatë, pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojë në ngjarje që kërkojnë korigjime materiale në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit që do të rezultojë në periudhat e ardhshme.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MË TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Vlerësime dhe supozime

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen dhe burime të tjera kyce të pasigurisë në vlerësimet në periudhën raportuese, që kanë një risk të madh të shkaktimit të një korigjimi material të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve në vitin e ardhshëm financiar, janë përshkruar më poshtë. Shoqëria i bazon supozimet dhe vlerësimet mbi parametrat që ka pasur në dispozicion kur janë përgatitur pasqyrat financiare. Rrethanat ekzistuese dhe supozimet në lidhje me zhvillimet e ardhshme mund të ndryshojë për shkak të ndryshimeve të tregut ose nga rrethana që dalin jashtë kontrollit të shoqërisë. Këto ndryshime janë reflektuar në supozimet kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një zhvlerësim ekziston kur vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë së gjenerimit të parasë tejkalon shumën e tij të rikuperueshme, e cila është shumën më të lartë mes vlerës së drejtë minus kostos së shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.

Llogaritja e vlerës së drejtë minus kostot për shitje bazohet në të dhënat në dispozicion nga transaksionet e shitjes në kushte normale aktiviteti për aktive të ngjashme ose nga cmime të observueshme tregu minus kostot shtesë për shitjen e aktivitetit ose nxjerrjen jashtë përdorimit të tij. Llogaritja e vlerës në përdorim është bazuar në modelin e skontimit të flukseve monetare. Flukset e mjeteve monetare janë bazuar te buxheti për pesë vitet e ardhshme dhe nuk përfshijnë veprimtaritë ristrukturuese që Shoqëria nuk është angazhuar ende ose investime të rëndësishme në të ardhmen që do të rrisin performancën e aktiveve të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare në testim.

Shuma e rikuperueshme është më e ndjeshme ndaj normës së skontimit të përdorur në modelin e skontimit të flukseve të parasë si edhe të flukseve të pritshme monetare në të ardhmen dhe normës së rritjes që përdoren për qëllime ekstrapolimi.

Shpenzime gërmimi të shtyra

Shoqëria i shtyn kostot e gërmimit të cilat janë të avancuara dhe që ndodhin gjatë fazës së prodhimit të aktiviteteve të saj. Llogaritja kërkon përdorimin e gjykimeve dhe matjeve si për shembull matjen e tonelatave humbjeve të cilat duhen hequr përgjatë jetesës së zonës minerale dhe si rezultat heqjen e rezervave të cilat mund të shpëtohen në mënyrë ekonomike. Ndryshimet në jetëgjatësinë e minierës do të rezultojnë në ndryshime të raportit të pritur të gërmimit. Këto ndryshime janë për tu marrë parasysh në të ardhmen.

Taksat

Pasiguri ekziston në lidhje me interpretimin e rregulloreve komplekse të taksave, ndryshimeve në ligjet tatimore, si dhe shumës dhe kohës së të ardhurave të ardhshme të taksueshme. Duke qënë se ekziston një gamë e gjerë e marrëdhënieve të biznesit ndërkombëtar si dhe një natyrë afatgjatë dhe kompleksitet i marrëveshjeve ekzistuese kontraktuale, linden diferenca midis rezultateve aktuale dhe supozimeve të bëra, ose, ndryshime të ardhshme të supozimeve mund të cojnë në nevojën e korigjimit të të ardhurave të taksueshme dhe shpenzimeve tashmë të rregjistruara.

Shoqëria krijon provigjone bazuar në vlerësime të arsyeshme lidhur me pasojat e mundshme nga auditime të kryera nga autoritetet tatimore të vendit në të cilin Shoqëria operon. Vlera e provigjoneve bazohet në disa faktorë, si psh: përvoja e mëparshme nga auditimet tatimore dhe interpretime të ndryshme të rregulloreve tatimore nga njësia e tatueshme ose autoriteti përgjegjës tatimor.

Diferencat e interpretimeve mund të shkaktohen nga çështje të ndryshme që varen nga kushtet ekzistuese në mjedisin ku Shoqëria operon. Kur Shoqëria e vlerëson të ulët probabilitetin që një çështje gjyqësore e lidhur me taksat të rezultojë në flukse dalëse monetare, ajo nuk njeht detyrime të

kushtëzuara. Aktivitetet e shtyra tatimore njihen për të gjitha humbjet e papërdorura tatimore deri në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm të mjaftojë për përdorimin e humbjeve. Për të përcaktuar vlerën e aktivitetit të shtyrë tatimor që do të njihet, duhet gjykim i konsiderueshëm nga manaxhimi, bazuar në kohën dhe vlerën e mundshme të fitimit të taksueshëm në të ardhmen, si dhe në strategjitë e planifikimit të tatimeve në të ardhmen.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

s. Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësime dhe supozime (vazhdim)

Kostot për restaurimin e mjedisit

Shoqërisë i kërkohet që të restaurojë zonën e minierës ose vendet e punimeve në fund të jetës së tyre të prodhimit dhe t'i kthejë në një gjendje të pranueshme nga autoritetet përkatëse dhe konform politikave mjedisore të Shoqërisë. Provizionet për restaurimin e mjedisit njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv si rezultat i ndodhive në të kaluarën, si dhe është e mundshme që një pjesë e burimeve do të kërkohen për shlyerjen e detyrimit dhe vlera është llogaritur në mënyrë të besueshme.

Llogaritja e kostove të ardhshme të këtyre detyrimeve është komplekse dhe kërkon manaxhimin të kryejë llogaritje dhe të përdorë gjykime sepse shumica e detyrimeve do të përbushen në të ardhmen dhe kontratat dhe ligjet zakonisht nuk janë të qarta përsa u përket atyre që kërkohen. Për më tepër, provizionet që do të krijohen influencohen më tej edhe nga ndryshimet në teknologji, mjedis, siguri, biznes dhe politikë.

Kostot që lidhen me aktivitetet restauruese llogariten me vlerën e tashme të të gjitha flukseve monetare që pritet të dalin në të ardhmen, dhe njihen si një aktiv më vete, brenda aktiveve afatgjata materiale dhe detyrimit përkatës. Kostoja e kapitalizuar amortizohet mbi jetën e dobishme të aktivitetit dhe cdo ndryshim në vlerën e tashme neto të detyrimit të pritshëm përfshihet në kostot financiare, përveçse kur ndryshimi në detyrim vjen si pasojë e ndryshimeve në gjykimet kontabël të vlerësimit.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në cdo periudhë të ardhme që ndikohet.

Në vecanti, informacioni rreth sferave të rëndësishme të pasigurisë në vlerësimet dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë më shumë efekt në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet e mëposhtme:

- Shënimi 11 – Shpenzimi për tatimin mbi fitimin
- Shënimi 12 – Aktiv tatimor i shtyrë
- Shënimi 17 – Llogaritë e arkëtueshme
- Shënimi 28 – Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

t. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria ka ekspozim kundrejt rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut nga përdorimi i instrumentave financiare. Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimet e shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme; objektivat, politikat dhe proceset e shoqërisë për të matur dhe manaxhuar rrezikun; si dhe manaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime të mëtejshme shpjeguese sasiore janë përfshirë në pasqyrat financiare dhe vecanërisht në shënimin 25. Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikqyrjen e strukturës së shoqërisë për menaxhimin e riskut (rrezikut).

Politikat e shoqërisë për manaxhimin e riskut janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rrezikun me të cilat përballet Shoqëria, për të përcaktuar kufij dhe kontrole rreziku të përshtatshme, si dhe për të monitoruar rrezikun dhe zbatimin e kufijve të përcaktuar. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet e kushteve të tregut dhe të aktiviteteve të shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve, procedurave dhe standardeve të manaxhimit ka për qëllim të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin punonjësit kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesore financiare të shoqërisë lidhen me paranë në arkë ose bankë, huatë me palët e lidhura, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, si dhe të tjera të arkëtueshme dhe detyrime.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

t. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Reziku i kredisë

Për shkak të volumit të madh dhe shumëllojshmërinë e bazës së klienteve të shoqërisë, përqëndrimet e rrezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme nga klientët janë të limituar. Zbritja (provigjoni) për llogaritë e dyshimta përcaktohet në një vlerë e cila konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqe potenciale në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.

Reziku i likuiditetit

Shoqëria gjeneron flukse monetare nga aktivitetet operative dhe beson se rreziku i likuiditetit nuk është i rëndësishëm.

Reziku i tregut

Reziku i normës së interesit

Shoqëria përballlet me rrezikun e normës së interesit që lidhet me huatë nga aksionerët të cilat kanë një normë të ndryshueshme. Manaxhimi nuk mban derivativë për të zbutur rrezikun.

Reziku i kursit të këmbimit

Shoqëria ka një ekspozim të madh kundrejt monedhave të huaja. Shoqëria ka hua afatshkurtra dhe afatgjata të denominuara në EURO.

Analiza e ndjeshmërisë

Shoqëria ka për qëllim uljen e impaktit të luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë, ndërsa manaxhon rrezikun e normës së interesit dhe kursit të këmbimit. Në një periudhë afatgjatë, ndryshime të përhershme në kursin e këmbimit dhe normës së interesit kanë një impakt në fitim. Në 31 dhjetor 2014, është llogaritur se një ndryshim në përqindjen e normës së interesit të zërave në LEK kundrejt monedhave të huaja do t'a impaktonte në mënyrë të konsiderueshme fitimin e shoqërisë përpara taksave.

Manaxhimi i kapitalit

Politika e shoqërisë është që të mbajë një bazë kapitali të fortë, si dhe të ketë besimin e investitorit, kreditorit dhe tregut për të mbështetur zhvillimet e biznesit në të ardhmen. Bordi i Drejtorëve monitoron kthimin mbi kapital, të cilin Shoqëria e përcakton si Të ardhura Operative neto përmbi Kapitalin e Vet. Gjithashtu, Bordi i Drejtorëve monitoron nivelin e dividendëve të aksionerëve të zakonshëm. Bordi kërkon të mbajë një ekuilibër midis kthimeve të larta të cilat janë të mundura me nivele më të larta të huave dhe avantazheve nga siguria e të pasurit një pozicion të mirë kapitali. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashme për kapitalin. Nuk ka pasur gjatë vitit ndryshime në trajtimin e manaxhimit të rrezikut financiar dhe kapitalit nga Shoqëria.

Periudhat krahasuese

Shifrat për periudhat krahasuese janë riklasifikuar ku është parë e përshtatshme, për të qënë në përputhje me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale. Këto riklasifikime, gjithsesi, nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme në përmbajtjen dhe formën e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

3. TË ARDHURAT NGA SHITJET

Shitjet e pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK' 000	LEK' 000
Shitje ferrokromi HC	6.711.854	4.932.199
Shitje mineral kromi	205.109	63.615
Shitje e materialeve të tjera	57.913	-
Total	6.974.876	4.995.814

4. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK' 000	LEK' 000
Leje kalimi Zona D	43.535	45.800
Sherbime të realizuara ndërmjet njërive	15.642	12.110
Rimbursim shpenzime operacionale	15.052	19.655
Të ardhura nga rrimarja e provigjioneve	13.629	-
Të ardhura nga skontot e lëshuara nga furnitorët	4.725	-
Të ardhura nga gjyqje të fituara	-	18.699
Total	92.583	96.264

5. BLERJE E MATERIALEVE

Kostoja e materialeve në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK' 000	LEK' 000
Mineral kromi nga palët e treta	1.450.302	758.878
Energji elektrike – Elbasan	1.033.586	1.264.972
Koks & gjysëm koks	717.753	585.226
Energji elektrike – Burrel	451.583	150.982
Energji elektrike – Bulqizë	123.633	86.553
Materiale të tjera – Elbasan	106.868	51.369
Elektroda	74.783	93.520
Materiale të tjera – Bulqize	56.381	103.017
Oksigjen, tuba dhe fleta çeliku	34.799	24.673
Materiale të tjera – Burrel	33.007	4.862
Karburantë dhe lubrifikantë	27.077	15.710
Dinamit	19.680	25.114
Shtylla, guida pusi & hekur	19.499	25.664
Energji elektrike – Klos	7.242	3.204
Tulla refraktare	6.300	28.018
Ferro Silico Chrome	938	-
Materiale të tjera – Klos	68	4.300
Materiale të tjera ndihmëse	-	70.908
Shpenzime të kapitalizuara	(244.046)	(145.803)
Total	3.919.453	3.151.207

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

6. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet për Personelin në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK' 000	LEK' 000
- Bulqiza	635.427	585.357
- Elbasan	173.651	165.668
- Burrel	104.945	54.940
- Tirana	67.375	58.939
- Klos	4.398	8.457
Pagat	985.796	873.361
- Bulqiza	105.793	86.007
- Elbasan	22.851	24.097
- Burrel	15.199	8.116
- Tirana	6.902	4.765
- Klos	646	1.329
Sigurime Shoqërore	151.391	124.314
- Bulqiza	15.529	15.815
- Elbasan	3.618	3.654
- Burrel	2.190	1.141
- Klos	-	12
Transport	21.337	20.622
Total	1.158.524	1.018.297

7. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzime të përgjithshme dhe administrative në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK' 000	LEK' 000
Transporti	200.463	94.661
Shërbime laboratorike dhe peshim	97.811	25.119
Ligjore dhe fatura profesionale	54.650	26.358
Sigurimi	46.227	44.837
Konsulencë financiare	42.827	42.817
Taksa për rentën minerare	42.093	81.151
Shërbime të realizuara ndërmjet njëjësive	15.642	-
Shpenzime të tjera	12.163	36.828
Udhëtime dhe akomodime	11.508	5.455
Siguracion	10.766	13.896
Penalitete	9.646	14.744
Shërbime bankare	8.416	11.655
Telefon dhe shërbime postare	6.879	6.063
Shpenzime porosie	5.355	5.782
Qira	4.247	4.098
Shpenzime pritje dhe përfaqsim	3.796	3.796
Taksa vendore	2.612	1.400
Mirëmbajtje dhe riparime	2.148	6.624
Total	577.249	425.284

Taksat përfshijnë rentën minerare e cila është llogaritur për sasinë e produktit të shitur dhe taksat vendore që ju paguhen bashkive.

Shpenzimet e tjera përfshijnë pagesat për tarifat e certifikatave të cilësisë, shpenzimet doganore, tarifa për shërbimet të ndryshme të njoftimit gazetë, shpenzime për pritje dhe përfaqësime etj.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

8. ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

Zhvlerësimi dhe amortizimi në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale (Shënimi 13)	300.498	256.750
Amortizimi i shpenzimeve të shtyra për gërmime (Shënimi 15)	59.997	93.729
Amortizimi i tarifave të konçesionit (Shënimi 14)	13.867	13.867
Zhvleresime per Aktive te qendrueshme Afatgjata (Shënimi 13)	353.230	-
Total	727.592	364.346

9. HUMBJET/FITIMET NETO NGA KURSI I KËMBIMIT

Humbjet/Fitimet neto nga kursi i këmbimit në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Fitimi nga kursi i këmbimit	702.479	301.964
Humbje nga kursi i këmbimit	(810.453)	(338.410)
Humbja neto	(107.974)	(36.446)

10. FITIM/ HUMBJE NGA INTERESI

Humbjet/ Fitimet neto nga interesi në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Shpenzime interesi për overdrafte	33.818	22.431
Shpenzime interesi për kredi me afat	516	4.475
Total	34.334	26.906
Të ardhura nga interesi	1.356	817
Total	1.356	817

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

11. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Tatimi mbi fitimin (Shpenzim)	187.142	58.252
	187.142	58.252

Rakordimi i shpenzimeve të tatimit të fitimit llogaritur me normën e tatimit ligjor mbi fitimin nga aktivitetet operative para tatimit mbi të ardhurat, me shpenzimet e tatim fitimit për llogaritur me normën efektive të tatimit mbi fitimin për Shoqërinë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Fitimi kontabël para Tatimit	737.684	357.987
Të ardhura të tjera të tatueshme	16.581	-
Të ardhura të patatueshme	-	(126.903)
Amortizimi i vitit me normat tatimore	108.724	129.057
Zhvleresim i aktiveve afatgjata materiale	353.230	-
Shpenzime të pazbritshme	31.396	28.205
Shpenzime të pazbritshme	493.350	157.262
Fitim i tatueshem\ (Humbje e zbrishme)	1.247.615	388.346
Shfrytëzimi i humbjeve të mbartura	-	-
Humbje/ Fitim i tatueshëm	1.247.615	388.346
Shpenzime per Tatimin Fitimin 15% (2014: 15%)	187.142	58.252
Parapagime	-	-
Tatimi mbi fitimin	(187.142)	(58.252)

Deklarimet tatimore përgatiten në baza vjetore por fitimet dhe humbjet të deklarara për qëllime fiskale nuk mund të konsiderohen të finalizuara deri kur organet tatimore ekzaminojnë deklaratat dhe dokumentacionin e tatimpaguesit dhe lëshojnë një vlerësim final. Ligjet dhe rregulloret fiskale janë subjekt i interpretimeve të ndryshme nga organet tatimore.

Në vitin 2015, të ardhurat e tjera të tatueshme përfaqësojnë të ardhurat të shtyra për t'u njohur gjatë vitit në vijim. Duke marrë në konsideratë që janë mallra të eksportuara por të pa mbëritura ende në destinacionin final shoqëria ka llogaritur tatimin mbi fitimin në momentin e eksportimit dhe do të njihen në të ardhura nga aktiviteti në momentin e mbërritjes së mallit në destinacionin final.

Në vitin 2014 të ardhurat e pataksueshme lidhen me rimarrjen e provigjoneve të inventarit në shumën 126.903 mijë.

Në bazë të legjislacionit tatimor humbjet fiskale mund të mbarten për 3 vite rresht. Gjithashtu në rastet kur ka ndryshim në pronësinë e një Shoqërie për më shumë se 50% të kapitalit aksioner ose të drejtave të votimit direkte ose të tërthortë humbjet fiskale të mbartura skadojnë. Si rrjedhojë e ndryshimit të pronesise me date 25 shkurt 2013 Shoqëria nuk ka humbje te mbartura te zbrishme ne periudhat qe vijne.

12. TATIM I SHTYRË

Tatimi i Shtyrë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbëhet si më poshtë:

	Pasqyra e Pozicionit Financiar		Pasqyra e të ardhurave	
	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Aktiv Tatimor i Shtyrë				
Amortizimi i përshpejtuar/ amortizim për qëllim tatimor	-	4.977	-	-
	-	4.978	-	-

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

13. ATKIVE AFATGJATA MATERIALE

Kosto	Toka LEK'000	Ndërtesa LEK'000	Makineri dhe pajisje LEK'000	Automjete LEK'000	Mobilje dhe pajisje elektronike LEK'000	Aktive në porces LEK'000	Totali LEK'000
Më 1 janar 2014	400	252.051	3.669.297	134.942	59.503	270.266	4.386.459
Shtesa	-	19.598	150.066	10.892	4.193	154.278	339.028
Pakësime	-	-	-	-	-	(6.306)	(6.306)
Transferime	-	-	19.041	-	-	(19.041)	-
Më 31 dhjetor 2014	400	271.649	3.838.404	145.835	63.696	399.198	4.719.181
Shtesa	-	-	305.033	20.957	9.319	44.302	379.611
Pakësime	-	-	(67.451)	-	-	-	(67.451)
Transferime	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	400	271.649	4.075.986	166.792	73.015	443.500	5.031.339
Amortizimi							
Më 1 janar 2014	-	79.012	1.897.277	80.935	23.818	-	2.081.042
Amortizimi i vitit	-	12.615	222.210	11.810	10.115	-	256.750
Më 31 dhjetor 2014	-	91.627	2.119.487	92.744	33.933	-	2.337.792
Shtesa	-	12.369	261.038	15.922	11.173	-	300.498
Pakesime	-	-	(21.020)	-	-	-	(21.022)
Më 31 dhjetor 2015	-	103.996	2.359.503	108.666	45.105	-	2.617.270
Zhvierësime							
Më 1 janar 2015	-	-	-	-	-	-	-
Zhvierësime	-	-	353.230	-	-	-	353.230
Më 31 dhjetor 2015	-	-	353.230	-	-	-	353.230
Vlera kontabël neto							
Më 31 dhjetor 2014	400	180.022	1.718.917	53.089	29.763	399.197	2.381.388
Më 31 dhjetor 2015	400	167.653	1.363.251	58.125	27.910	443.500	2.060.839

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

13. ATKIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Në vitin 2015 shoqëria realizoi rivlerësim të asetit afatgjatë, "Furra për prodhim Ferro Kromi me karbon të ulët", aset i cili është blerë nga shoqëria në vitin 2009. Në bazë të opinioneve të eksperteve të huaj me vite eksperiencë dhe inxhinieret në shqipëri rezultojnë që struktura e plotë e këtij asetit është i papërshtatshëm dhe vënia në përdorim i tij ka kosto si financiare gjithashtu edhe mjedisore duke patur parasysh natyrën e produktit që prodhohet.

Duke marrë në konsideratë përse më sipër shoqëria ka vlerësuar asetin me vlerën LEK 50,316 mijë duke njohur vlerën e mbetur në shpenzime zhvlersimi për asete të pazbritshme nga tatim fitimi.

Nuk ka aktive të vendosura si kolateral më 31 dhjetor 2015 dhe të gjitha aktivet janë të lira nga pengesat. Menaxhimi ka vlerësuar në datën e raportimit, duke u bazuar në planet e zhvillimit, që nuk ka tregues të rënies në vlerë, dhe flukset monetare të ardhshme do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar vlerën kontabël të aktiveve të Shoqërisë.

Qerramarrje Financiare

Vlera e mbartur e mjeteve të marra nën kredinë financiare më 31 dhjetor 2015 është LEK 12.163 mijë (31 Dhjetor 2014; LEK 9.692 mijë), ju lutem referojuni shënimit 21.

Sikurse është shpjeguar në shënimet 1 dhe 14, Shoqëria si pjesë e koncesionit BOT, ka marrë në përdorim disa aktive afatgjata materiale nga qeveria. Gjithësesi për shkak se pronësia e këtyre aktiveve nuk është transferuar tek Shoqëria, kjo e fundit nuk i ka pasqyruar këto aktive në librat e saj të kontabilitetit. Për më tepër Shoqëria ka regjistruar tarifën e koncesionit të paguar qeverisë e cila i jep të drejtën shoqërisë për ti përdorur këto aktive.

Përveç makinave të marra me qera të cilat shërbejnë si kolateral për të siguruar kontratën e qerasë financiare.

14. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE

Aktivitet afatgjata jo-materiale në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave janë analizuar si më poshtë:

	Tarifa e koncesionit Elbasan	Tarifa e koncesionit Bulqize	Totali
Kosto:			
Më 1 janar 2014	168.000	248.000	416.000
Shtesa	-	-	-
Më 31 dhjetor 2014	168.000	248.000	416.000
Shtesa	-	3.258	3.258
Më 31 dhjetor 2015	168.000	251.258	419.258
Amortizim:			
Më 1 janar 2014	77.000	104.023	181.023
Amortizimi për vitin	5.600	8.266	13.867
Më 31 dhjetor 2014	82.600	112.289	194.889
Amortizimi për vitin	5.600	8.266	13.866
Më 31 dhjetor 2015	88.200	120.556	208.756
Vlera kontabël neto:			
Më 31 dhjetor 2014	85.400	135.711	221.111
Më 31 dhjetor 2015	79.800	130.702	210.502

Shoqëria më 1 qershor 2000 mori një koncesion të tipit **BOT (Ndërto Opero Transfero)** për objektet e mëposhtme për 30 vjet: një fabrikë Ferro-kromi në Elbasan dhe dy miniera kromi në Përrenjas dhe Pojsk, për shumën prej LEK 168.000 mijë.

Shoqëria më 22 qershor 2001 mori një koncesion të tipit **BOT (Ndërto Opero Transfero)** për objektet e mëposhtme për 30 vjet: Një minierë Ferro-kromi në Bulqizë, një fabrikë mineralesh në Bulqizë, një fabrikë për përzgjedhjen e mineraleve në Klos dhe një fabrikë ferro-kromi në Burrel për një shumë prej LEK 248.000 mijë.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

15. AKTIVET MINERARE TË SHTYRA

Aktivet afatgjata të shtyra lidhen me kostot e shtyra të gërmimit në minierë. Kostot e shtyra të gërmimit janë të lidhura me nivelet specifike të minierës. Kjo përfaqëson kostot e realizuara nga Shoqëria për të hapur rrugën në mënyrë që të ketë akses tek minerali. Kostot e shtyra të gërmimit amortizohen në bazë të sasisë së mineraleve të nxjerrë për çdo nivel me të cilin këto kosto lidhen.

	Kosto gërmimi të shtyra	Investime per germime të reja	Total
Kosto:			
Më 1 janar 2014	698.328	32.555	730.883
Shtesa	48.825	286.305	335.130
Më 31 dhjetor 2014	747.153	318.860	1,066,013
Shtesa	103.364	501.116	604.480
Interes i kapitalizuar		45.052	45.052
Më 31 dhjetor 2015	850.517	865.028	1.715.545
Amortizimi:			
Më 1 janar 2014	479.381	-	479.381
Amortizimi për vitin	93.730	-	93.730
Më 31 dhjetor 2014	573.111	-	573.111
Amortizimi për vitin	59.997	-	59.998
Më 31 dhjetor 2015	633.108	-	633.107
Vlera kontabël neto:			
Më 1 janar 2014	218.947	32.555	251.502
Më 31 dhjetor 2014	173.795	318.860	492.904
Më 31 dhjetor 2015	217.410	865.028	1.082.438

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

16. INVENTARI

Inventarët në pasqyrën e pozicionit financiar janë vlerësuar me kosto ose vlerën neto të realizueshme dhe analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
Mallra te gatshem	1.055.937	1.035.690
Lëndët e para	431.465	205.826
Inventarë të tjerë	298.758	215.629
Mallra gjysëm të gatshëm	12.896	13.909
Inventari bruto	1.799.056	1.471.054
Provigjone	(31.146)	(44.774)
Total	1.767.909	1.426.190

Inventarët e njohur si shpenzim për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë LEK 3.919.453 mijë (31 dhjetor 2014: LEK 3.297.011 mijë). Provigjonet janë krijuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
Lëndët e para	-	-
Mallra gjysëm të gatshëm	4.604	4.604
Inventarë të tjerë	26.542	40.170
Total	31.146	44.774

Levizjet ne vleren neto te realizueshme jane si me poshte:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
Provigjone		
Më 1 janar	(44.774)	(171.678)
Rekuperimi i provigjonit	13.628	126.904
Më 31 dhjetor	(31.146)	(44.774)

Rekuperimi i provigjoneve kryesisht ka të bëjë me përdorimin e lëndëve të para të grumbulluara në procesin e prodhimit. Rekuperimi neto i provigjoneve prej LEK 13.629.681 mijë është i përfshirë së bashku me koston e materialeve në Shënimin 5. Për vitin 2015 pavarësisht uljes së cmimit të Ferrokromit "FeCr" nuk është krijuar provigjion nga ana e kompanisë.

Më 31 dhjetor 2015, shoqëria ka inventarë të vendosur si kolateral në lidhje me dy overdraftet e marra pranë bankave Raiffeisen dhe Societe General Albania. Kolaterali i vendosur për overdraftin nga Raiffeisen Bank është jo më pak se 3 milione euro inventarë i përbërë nga FeCr kokërr, Ferrokrom me përqindje të lartë karboni, mineral koncentrat kromi, mineral kromi pluhur etj. Gjithashtu në lidhje me overdraftin nga Banka Societe General Albania, kolaterali i vendosur është mbi inventarin e shoqërisë që mbulon 200% ekspozimin e kredisë.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

17. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
Llogari të arkëtueshme nga eksportet	414.240	282.741
Llogari të arkëtueshme nga klientë lokal	75.650	90.124
Të ardhura të papërfituara	(70.413)	-
Total	419.477	372.865

Llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes dhe në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor midis 30-180 ditë.

Në vitin 2015, të ardhurat e papërfituara përfaqsojnë të ardhurat për t'u njohur gjatë vitit në vijim duke marrë në konsideratë që janë mallra të eksportuara por të pa mbëritura ende në destinacionin.

18. TË TJERA AKTIVE TË ARKËTUESHME

Llogaritë e tjera të arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
TVSH e kreditueshme	419.388	340.970
Garanci për çështjet me taksat, neto (shenim 18.1)	96.099	96.099
Parapagimet për furnitorët	54.158	42.269
Rentë minerare e arkëtueshme	17.316	17.316
Parapagimet për stafin	2.055	4.081
Parapagim për tatimin mbi fitimin	-	345.717
Parapagime të shtyra	-	27.465
Të arkëtueshme të tjera	-	4.025
Total	589.016	877.942

Shoqëria ka marrë pagesa periodike të TVSH-së. Ligji i ri i TVSH-së në Shqipëri kërkon që shoqëritë të rimbursohen brenda 60 ditëve nga deklarimi i TVSH-së se tyre të arkëtueshme dhe si rezultat TVSH-ja konsiderohet plotësisht e rikuperueshme në kohën e duhur.

Renta minerare e rimbursueshme lind nga blerja e mineralit të kromit nga shoqëri të tjera lokale që e kanë paguar tashmë rentën mirerare.

18.1 Garanci për çështjet me taksat, neto

Në bazë të shpjegimit në shënimin 28c Shoqëria ka krijuar një provigjon lidhur me garancitë e bllokuara përse i përket çështjeve me autoritetet tatimore. Lëvizja në provigjonin e krijuar është si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
Garanci për çështjet me taksat, bruto	238.159	238.159
Provigjone per humbje më 1 janar	(142.060)	(142.060)
Rimarrje gjatë periudhës	-	-
Provigjone per humbje më 31 dhjetor	(142.060)	(142.060)
Garanci për çështjet me taksat, neto	96.099	96.099

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

19. MJETE MONETARE DHE TË NGJAJSHME

Mjete monetare dhe të ngjashme në pasqyrat e pozicionit financiar janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
Mjete monetare në Bankë	118.226	153.548
Depozita	80.000	-
Mjete monetare në Arkë	295	324
Total	198.521	153.872

20. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar në pasqyrën e pozicionit financiar është analizuar si më poshtë:

	Numri i	% e	Vlera Nominale
	Aksioneve	pjesëmarrjes	LEK' 000
Autorizuar, emetuar dhe paguar plotësisht			
ACR Holding SRL – Itali	68.470	100%	6.847.113
Total	68.470	100%	6.847.113

Më 25 shkurt 2013 kapitali aksionar i Shoqërisë ka qënë 1.310 mijë LEK i përbërë nga 13.100 aksione me vlerë nominale prej 100 LEK.

Më 30 maj 2013 aksioneri i vetëm i Shoqërisë ACR Holding vendosi të kapitalizojë dy kreditë e mundësuar kompanisë në kapital aksionar, si psh 55.370 aksionet e reja të lëshuara me vlerën nominale prej LEK 100 mijë. Si pasojë kapitali aksionar u rrit me LEK 5.527.113. mijë.

Më 11 gusht 2015 Shoqëria miratoi zvogëlimin e kapitalit në vlerën e barabartë me LEK 3.081.150 mijë nëpërmjet zvogëlimit të humbjeve të mbartura. Vlera nominale nga 100 lekë bëhet 55 lekë për aksion.

	Kapitali	Humbjet e	Totali
	'000 LEK	akumuluar ne	'000 LEK
		'000 LEK	
Më 31 dhjetor 2014	6.847.113	(3.203.956)	3.643.157
Zvogëlim i kapitalit për të mbuluar humbjet e mbartura	(3.081.150)	3.081.150	-
Më 31 dhjetor 2015	3.765.963	(122.806)	3.643.157

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

21. HUAMARRJET

Shoqëria ka marrë hua financiare nga aksionerët dhe nga institucionet financiare si vijon:

	Norma efektive e interesit %	Maturiteti	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Huamarrjet afatgjata				
Tirana Bank – Kredi	6.75 %	27 tetor 2021	683.339	369.302
Pjesa afatshkurtër e huamarrjeve afatgjata				
Tirana Bank – Kredi	6.75 %	27 tetor 2021	110.216	61.550
Huamarrjet afatshkurtra				
Raiffeisen Bank – Overdraft	8.44 %	27 gusht 2015	137.654	145.306
Societe General Bank- Overdraft	6.00 %	23 dhjetor 2015	43.500	432.995
	Euribor 12M			
Leasing- Qera financiare	+4.5%-5.5%		12.163	9.692
			986.872	1.018.845

Vlera kontabël e huamarrjeve është e përafert me vlerën e tyre të drejtë meqenese gjithë huamarrjet janë marre me kushte tregu.

22. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme janë detyrime që nuk mbartin interes me furnitorët vendas dhe të huaj dhe që normalisht shlyhen brenda një periudhe 30 deri në 180 ditë.

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve	581.015	391.452
Të përlogaritura ndaj furnitorëve	(26.888)	212.420
Total	554.127	603.872

23. DETYRIME TË TJERA

Detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit financiar janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Detyrimet ndaj METE	223.411	236.231
Detyrime të tjera	142.669	4.746
Shpenzime të përlogaritura për paga	69.099	65.236
Provizione të tjera	68.189	68.168
Kontributet ndaj sigurimeve shoqërore dhe taksat	42.240	31.192
Detyrimet e koncesionit	24.999	27.804
Total	570.606	433.337

Detyrimet ndaj Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ("METE") përfshijnë një shumë prej EUR 1.639 mijë ose LEK 223.426 mijë (31 dhjetor 2014: LEK 229.689 mijë) e lidhur me penalitetet e vendosura nga Ministria por që nuk janë shlyer ende nga Shoqëria. Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje me METE më 9 korrik 2009 për të paguar penalitetin në momentin që të arkëtueshmet nga TVSH janë rimbursuar.

Detyrime të tjera, përfshin kryesisht parapagime për blerje të kromit në dhjetor 2015 bazuar në fatura pro-forma.

Provizione të tjera lidhen me auditimin tatimor nga 2010 për tatimin nga të ardhurat e korporatave dhe nuk ka asnjë levizje në provigjion gjatë vitit.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

24. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria konsideron si palë të lidhur Grupin Balfin i cili bleu Shoqërinë pas fundit të vitit por që kishte filluar të financonte shoqërinë përpara mbylljes së vitit financiar. Balfin sh.p.k është pala kontrulluese përfundimtare. Shoqëria ishte e kontrolluar nga DCM – Decometal deri ne shkurt 2013, por gjate vitit 2013 deri ne humbjen e kontrollit nuk ka pasur transaksione me grupin DCM Dekometal.

Tabelat e mëposhtme tregojnë shumën totale të transaksioneve që janë kryer me palët e lidhura në vitin e caktuar financiar.

a) Llogari të arkëtueshme nga / te pagueshme per palët e lidhura

Tepricat e arkëtueshme/pagueshme që rrjedhin nga transaksionet e përmendura më sipër janë paraqitur më poshtë:

LEK '000	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Hua nga shoqëria mëmë përfundimtare	-	216.783	-	216.783
Nga shoqëria mëmë përfundimtare	19.884	9.229	-	9.229
Nga shoqëritë e grupit	3.514	5.286	-	5.286
Total	23.398	231.998	-	231.998

Më 1 gusht 2014, Shoqëria nënshkroi një kontratë kredie prej USD 2.272 mijë me pronarin e ri Balfin shpk., e cila u shlye në fillim të vitit 2015.

b) Blerja e mallrave dhe shërbimeve / shpenzimet

Blerja e mallrave dhe shërbimeve nga palët e lidhura janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Nga shoqëria mëmë përfundimtare	10.721	29.664
Nga shoqëritë e grupit	42.246	8.640
Total	52.967	38.304

25. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT

Instrumentat kryesore financiarë të shoqërisë përbëhen nga kredi bankare dhe hua afatshkurtra, para dhe depozita afatshkurtra. Qëllimi kryesor i këtyre instrumentave financiare është të sigurojë financim për aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria ka edhe disa aktive dhe detyrime financiare të tjera si për shembull llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme, që rrjedhin direkt nga aktivitetet e saj. Manaxhimi i riskut kryhet sipas politikave të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

Shoqëria ka ekspozim kundrejt rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut nga përdorimi i instrumentave financiare. Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimet e shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme; objektivat, politikat dhe proceset e shoqërisë për të matur dhe manaxhuar rrezikun; si dhe manaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikqyrjen e strukturës së shoqërisë për menaxhimin e riskut (rrezikut).

Politikat e shoqërisë për manaxhimin e riskut janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rrezikun me të cilat përballet Shoqëria, për të përcaktuar kufij dhe kontrole rreziku të përshtatshme, si dhe për të monitoruar rrezikun dhe zbatimin e kufijve të përcaktuar. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet e kushteve të tregut dhe të aktiviteteve të shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve, procedurave dhe standardeve të manaxhimit ka për qëllim të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin punonjësit kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesore financiare të shoqërisë lidhen me paranë në arkë ose bankë, huatë me palët e lidhura, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, si dhe të tjera të arkëtueshme dhe detyrime.

Manaxhimi rishikon dhe aprovon politikat për menaxhimin e secilit prej këtyre rreziqeve të cilat janë përmbledhur më poshtë.

Menaxhimi i riskut financiar

Rreziku i kredisë

Për shkak të volumit të madh dhe shumëllojshmërinë e bazës së klienteve të shoqërisë, përqëndrimet e rrezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme nga klientët janë të limituar. Zbritja (provigjoni) për llogaritë e dyshimta përcaktohet në një vlerë e cila konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqe potenciale në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.

Rreziku i likuiditetit

Shoqëria gjeneron flukse monetare nga aktivitetet operative dhe beson se rreziku i likuiditetit nuk është i rëndësishëm.

Rreziku i tregut

Rreziku i normës së interesit

Shoqëria përballet me rrezikun e normës së interesit që lidhet me huatë nga aksionerët të cilat kanë një normë të ndryshueshme. Manaxhimi nuk mban derivativë për të zbutur rrezikun.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria ka një ekspozim të madh kundrejt monedhave të huaja. Shoqëria ka hua afatshkurtra dhe afatgjata të denominuara në EURO.

Analiza e ndjeshmërisë

Shoqëria ka për qëllim uljen e impaktit të luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë, ndërsa manaxhon rrezikun e normës së interesit dhe kursit të këmbimit. Në një periudhë afatgjatë, ndryshime të përhershme në kursin e këmbimit dhe normës së interesit kanë një impakt në fitim. Në 31 dhjetor 2014, është llogaritur se një ndryshim në përqindjen e normës së interesit të zërave në LEK kundrejt monedhave të huaja do t'a impaktonte në mënyrë të konsiderueshme fitimin e shoqërisë përpara taksave.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

25. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT (VAZHDIM)

Manaxhimi i kapitalit

Politika e shoqërisë është që të mbajë një bazë kapitali të fortë, si dhe të ketë besimin e investitorit, kreditorit dhe tregut për të mbështetur zhvillimet e biznesit në të ardhmen. Bordi i Drejtorëve monitoron kthimin mbi kapital, të cilin Shoqëria e përcakton si Të ardhura Operative neto përmbi Kapitalin e Vet. Gjithashtu, Bordi i Drejtorëve monitoron nivelin e dividendëve të aksionerëve të zakonshëm. Bordi kërkon të mbajë një ekuilibër midis kthimeve të larta të cilat janë të mundura me nivele më të larta të huave dhe avantazheve nga siguria e të pasurit një pozicion të mirë kapitali. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashme për kapitalin. Nuk ka pasur gjatë vitit ndryshime në trajtimin e manaxhimit të rrezikut financiar dhe kapitalit nga Shoqëria.

Periudhat krahasuese

Shifrat për periudhat krahasuese janë riklasifikuar ku është parë e përshtatshme, për të qënë në përputhje me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale. Këto riklasifikime, gjithsesi, nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme në përmbajtjen dhe formën e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare.

a) Rreziku i normave të interesit

Ekspozimi i shoqërisë ndaj riskut për ndryshime në normat e interesit të tregut lidhet kryesisht me huamarrjet afatgjata të shoqërisë që janë me normë interesi të ndryshueshme. Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria ka borxh me normë interesi fikse nga shoqëria mëmë dhe borxh me normë interesi të ndryshueshme nga bankat.

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
Instrumentat me normë interesi fikse		
Aktive financiare	-	-
Detyrime financiare	-	219.286
Instrumentat me normë interesi të ndryshueshme		
Aktive financiare	-	-
Detyrime financiare	805.718	1.018.791

Një ndryshim prej 100 deri 300 pikë bazë në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të kishte ndikim të rëndësishëm në rezultatin financiar të shoqërisë.

Të ardhurat dhe flukset monetare operative të shoqërisë janë në mënyrë të konsiderueshme të pavarura nga ndryshimet e normave të interesit të tregut, gjithsesi efekti që një ndryshim në normat e interesit do të kishte në rezultatet e Shoqërisë është rritur për shkak të rritjes në huatë afatshkurtra deri afatmesme, në monedhën LEK, që do të ndikonte në uljen e fitimit para tatimit, si vijon:

	31 dhjetor 15	31 dhjetor 14
	LEK'000	LEK'000
Rritje prej 100 Pikë Bazë	(8.057)	(10.188)
Në % të fitimit/humbjes para tatimit	(0.74%)	(2.42%)
Rritje prej 300 Pikë Bazë	(24.172)	(30.564)
Në % të fitimit/humbjes para tatimit	(2.22%)	(7.27%)

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare

Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

25. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT (VAZHDIM)

b) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria hyn në transaksione në valutë të huaj në lidhje me shitjet e produkteve të saj dhe blerjen e aktiveve fikse dhe blerjet e mallrave tregtare nga palët e lidhura. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument të veçantë financiar kundër këtyre risqeve, dhe nuk ka instrumente të tilla në përdorim të gjerë në Republikën e Shqipërisë. Prandaj, Shoqëria është e ekspozuar potencialisht ndaj risqeve të tregut që lidhen me luhatjet e mundshme të kurseve të këmbimit të valutave të huaja.

31 dhjetor 2015
në LEK'000

	Totali	EURO	USD	ALL
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	944.952	11	673	464.196
Mjete monetare në bankë dhe arkë	198.521	832	-	84.264
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(884.467)	(1.108)	(396)	(302.844)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(23.398)	(170)	-	-
Huamarrje nga palë të lidhura	-	-	-	-
Huamarrje me interes	(303.353)	(89)	(2.316)	-
Ekspozimi Neto	(67.745)	(524)	(2.040)	245.616

31 dhjetor 2014
në LEK'000

	Totali	EURO	USD	ALL
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	1.250.807	20.626	377.666	852.515
Mjete monetare në bankë dhe arkë	153.872	4.122	147.555	2.195
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(1.037.249)	(299.947)	(189.337)	(547.965)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(15.215)	(5.135)	(4.598)	(5.482)
Huamarrje nga palë të lidhura	(216.783)	-	(216.783)	-
Huamarrje me interes	(1.018.845)	(9.692)	(1.009.153)	-
Ekspozimi Neto	(883.413)	(290.025)	(894.650)	301.262

Kurset e këmbimit të aplikuara gjatë vitit:

në LEK	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2015	2014	2015	2014
EURO 1	139,75	139,97	137,28	140,14
USD 1	125,98	105,48	125,79	115,23

c) Rreziku i likuiditetit

Politikat e kujdesshme të manaxhimit të riskut të likuiditetit nënkupton ruajtjen e mjeteve monetare të mjaftueshme dhe disponueshmërinë e fondeve me anë të një sasive të mjaftueshme linjash krediti.

Tabela më poshtë përmbledh profilin e maturimit të detyrimeve financiare të shoqërisë në 31 dhjetor 2015 dhe 2014, bazuar në pagesat kontraktuale të paskontuara.

Më 31 dhjetor 2015 në '000 LEK	Më pak se 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 në 5 vjet	> 5 vjet	Total
Huamarrje afatshkurtra	-	122.379	683.339	-	805.718
Llogari të pagueshme dhe të tjera	-	939.741	-	-	939.741
Detyrime ndaj palëve të lidhura	-	23.398	-	-	23.398
Total	-	1.085.518	683.339	-	1.768.857

Më 31 dhjetor 2014 në '000 LEK	Më pak se 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 në 5 vjet	> 5 vjet	Total
Huamarrje ndaj palëve të lidhura- rrjedhëse	-	216.783	-	-	216.783
Huamarrje afatshkurtra	-	649.543	-	369.302	1.018.845
Llogari të pagueshme dhe të tjera	-	1.037.249	-	-	1.037.249
Detyrime ndaj palëve të lidhura	-	15.215	-	-	15.215
Total	-	1.918.790	-	369.302	2.288.092

25. ADMINISTRIMI I RISKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT (VAZHDIM)

d) Rreziku i kreditit

Shoqëria nuk ka përqendrim të konsiderueshëm të riskut të kredisë. Shoqëria ka aprovuar politika të tilla krediti për të siguruar që shitja e produkteve të bëhet për klientët me një histori krediti të përshtatshme. Shoqëria ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredisë për çdo klient. Përveç kësaj, për të zvogëluar këtë rrezik Shoqëria ka kërkuar si kolateral garanci bankare dhe depozita bankare. Rreziqet e njohura janë marë parasysh duke krijuar provigjone për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Në lidhje me risqet e kreditit që rrjedhin nga aktivet e tjera financiare të shoqërisë, të cilat përbëhen nga paraja dhe ekuivalentët dhe të tjera të arkëtueshme afatshkurtra të shoqërisë, ekspozimi i shoqërisë ndaj riskut të kreditit lind nga vonesa e palës tjetër, me një ekspozim maksimal të barabartë me vlerën kontabël të këtyre instrumenteve.

e) Rreziku i çmimit të mineralit

Shoqëria shet të gjithë prodhimin në tregun e huaj, si rrjedhojë çmimi i shitjes është i ndikuar nga lëvizshmëria e çmimeve në bursë. Shoqëria nuk është duke përdorur ndonjë instrument mbrojtës ose kompensimi për ndryshimet e çmimeve në bursë.

26. VLERA E DREJTË

Vlera e drejtë e aktiveve afatshkurtra dhe pasiveve afatshkurtra me pale treta i përafrohet vlerave të mbartura për afate kohore të shkurtra lidhur me natyrën e tyre afatshkurtër. Vlera e drejtë e huave afatgjata ndryshon nga vlera e mbartur pasi ato kanë normë interesi fikse.

Hierarkia e vlerës së drejtë

Menaxhimi është bazuar në gjykim për të konkluduar që vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë i përafrohet vlerës së tyre të mbartur. Si rrjedhojë, gjithë vleresimet në lidhje me vlerën e drejtë kategorizohen në Nivelin 3 sipas SNRF 7.

27. MENAXHIMI I KAPITALIT

Objektivi kryesor i menaxhimit të kapitalit të shoqërisë është që të sigurohet se ajo ka një vlerësim të fortë përse i përket riskut të kreditit dhe raporteve të shëndetshme të kapitalit në mënyrë që të mbështesin biznesin e tyre dhe për të maksimizuar pasurinë e aksionerëve. Shoqëria menaxhon kapitalin dhe strukturën e saj dhe bën korrigjimet e nevojshme, në varësi të ndryshimeve në kushtet ekonomike. Për të ruajtur apo për të rregulluar strukturën e kapitalit, Shoqëria mund të rregullojë pagesën e dividendëve për aksionerët, të kthejë kapital te aksionerët apo të emetojë aksione të reja.

Nuk ka pasur ndryshime në qëllimet, politikat ose proceset gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe në vitin aktual 2015.

Shoqëria monitoron kapitalin duke përdorur si matës raportin e borxhit, i cili është borxhi neto i pjesëtuar me totalin e kapitalit duke i shtuar borxhin neto. Politika e shoqërisë është që të mbajë këtë raport borxhi në nivele të pranueshme duke marrë parasysh nivelin ekonomik. Shoqëria përfshin në borxhin neto, huamarrje me interes dhe kreditë e marra nga palët e treta duke përjashtuar shoqërinë mëmë, llogaritë e pagueshme minus aktivet likuide. Kapitali vetë përfshin kapitalin që i atribuohet aksionerëve të shoqërisë mëmë dhe kreditë e marra nga shoqëria mëmë.

Albchrome sh.p.k
Shënime të pasqyrave financiare
Për vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2015

27. MENAXHIMI I KAPITALIT (VAZHDIM)

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Kredi dhe huamarrje me interes	986.872	1.018.845
Llogari të pagueshme	554.127	603.872
Minus: Mjete monetare dhe depozitat afatshkurtra	(198.521)	(153.872)
Borxhi Neto	1.342.478	1.468.845
Kapitali	4.193.698	3.645.369
Kreditë e marra nga Shoqëria mëmë	-	216.783
Totali i Kapitalit	4.193.698	3.862.152
Kapitali dhe Borxhi Neto	5.536.176	5.330.997
Raporti i Borxhit	24.25%	27.55%

28. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

a) Angazhime

Shoqëria ka marrë qera financiare dhe operative për disa mjete të përfshira nën kategorinë e aktiveve afatgjata materiale. Sipas kontratave, pagesat e ardhshme janë si më poshtë:

	31 dhjetor 15 LEK'000	31 dhjetor 14 LEK'000
Brenda vitit		
Qeramarrje operative	10.577	5.045
Qeramarrje financiare	7.907	6.110
Investimet në pusin 9	754.917	4.715.000
	773.402	4.726.155
Pas 1 por jo më shumë se 5 vjet		
Qeramarrje operative	22.405	20.180
Qeramarrje financiare	4.256	6.005
Investimet në pusin 9	783.785	225.957
	810.446	252.142
Total	1.583.848	4.978.297

Shoqëria ka një kontratë për shërbime në distancë për investimet që do të kryhen në pusin 9 me palë të treta. Gjithashtu tek angazhimet përfshihen kontrata qeraje operative për zyra dhe ambiente të tjera në përdorim nga Shoqëria. Gjatë vitit 2015 Shoqëria regjistroi shpenzime në shumën LEK 4.247 mijë (31 dhjetor 2014: LEK 4.098 mijë) për marrje me qera të ndërtesave, por gjithashtu edhe për qeramarrje të magazinave dhe pajisjeve bazuar në nevojat e saj.

b) Çështje ligjore

Gjatë vitit 2015, Shoqëria ka qenë subjekt i çështjeve të ndryshme gjyqësore ku ndër më të rëndësishmet janë në lidhje me kamatvonesat nga rimbursimi me vonesë i TVSH-së, njoftim vlerësimin datë 8.10.2013 për uljen e humbjeve të vitit 2012, dhe njoftim vlerësimin datë 18.4.2014 për rimbursimin e rentës minerare.

Shoqëria gjatë rrjedhës së rregullt të aktivitetit të saj është përfshirë në çështje të ndryshme ligjore nën gjykim si paditës dhe palë e paditur nga palë të treta dhe punonjës të larguar nga puna. Shoqëria ka një pritshmëri pozitive për të gjitha gjyqet e mësipërme.

29. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje të rëndësishme pas datës së pozicionit të pasqyrave financiare, që kërkon rregullime ose informacione shpjeguese në pasqyrat financiare.